



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 14, pika 14.1 dhe 14.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 32, pika 32.3, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2008, merr

V E N D I M
PËR DHËNIEN E NGASTRËS KADASTRORE, NË SHFRYTËZIM
TË PËRKOHSHËM, KLUBIT FUTBOLLISTIK "BARDHOSHI" NË BARDHOSH

Neni 1

Jepet në shfrytëzim të përkohshëm pjesa e ngastrës kadastrore 396/1, me pronar Komuna e Prishtinës, fleta poseduese 145, në sipërfaqe prej 12 500 m² klubit futbollistik "Bardhoshi" në Bardhosh.

Neni 2

E drejta e shfrytëzimit të tokës, e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, jepet për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej 10 vjetësh, me mundësi vazhdimi.

Neni 3

Mënyra e shfrytëzimit të tokës, sipas këtij Vendimi, do të rregullohet me kontratë të veçantë në mes të Komunës dhe shfrytëzuesit dhe në të nuk mund të ndërtohen objekte me material të fortë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtorisë për Pronë

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr.110-1903, më 29.12.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa